



Në bazë të parimeve të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë me Nr. 04/L-161 neni 20 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si dhe neni 22 të Rregullores për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës të KEK-ut. Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, në seancën e vet të mbajtur me datë 29 janar 2015 aprovoi këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR AFTËSIMIN E TË PUNËSUARVE PËR PUNË TË SIGURT**  
**NË**  
**KORPORATËN ENERGETIKE TË KOSOVËS**

**Neni 1.**

Përmes aftësimit të punëtorëve për punë të sigurt (në vazhdim: aftësimi i punëtorëve), realizohet njohja teorike dhe praktike e dijes në fushën e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së shëndetit, njihen me kushtet e punës, njihen me rreziqet dhe dëmtuesit që përmbajnë vendet e caktuara të punës, njihen me mjetet e punës, masat mbrojtëse në punë, pajisjet personale mbrojtëse në punë dhe MKZ.

**Neni 2.**

Aftësimi i punëtorëve për punë të sigurt, ana teorike dhe praktike, bëhet në rastet:

- 1) E lidhjes së kontratës në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit (lidhja e marrëdhënies së punës)
- 2) E ndërrimit të vendit të punës,
- 3) Futjen e teknologjive të reja në proceset punuese.

**Neni 3.**

Organizimi i trajnimit të punëtorëve mbahet në tri nivele – module të trajnimit drejtpërdrejt në objektet e departamentit/ Divizionit apo përmes Qendrës së trajnimit (në objektet e qendrës së trajnimit).

Moduli i parë: aftësimi i punëtorëve për punë të sigurte, njohurit themelore të Sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri si dhe përdorimit të PPM, detyrat dhe obligimet që dalin nga Rregullorja e Sigurisë dhe ambientit të punës dhe Ligjeve në fuqi.

Moduli i dyte : aftësimi i stafit tekniko mbikëqyrës ( inxhinjerik) njohuri plotësuese me programin e menaxhimit te Sigurisë si dhe implementimin e rregullave, standardeve te sigurisë ne pune.

Moduli i tret: aftësimi i stafit menaxheria dhe menaxhues me Programin e Sigurisë dhe implementimin e tije përmes menaxhimit te Depertamenteve dhe Divizioneve.

Aftësimi i punëtorëve bëhet nga punëdhënësi dhe gjatë orarit të punës.

#### **Neni 4.**

Pas trajnimit te personelit, duhet të bëhet verifikimi i njohurive dhe aftësive të fituara.

1. Aftësimin e punëtorëve e bëjnë inspektorët e mbrojtjes në punë, në divizionin apo departamentin përkatës, ose përmes personeli te certifikuar për aftësim të të punësuarve.
2. Pasuesi 1, nuk vlen për nxënës praktikant apo student praktikant për të cilët ka rregullore të veçantë për aftësimin e tyre nga fusha e sigurisë në punë.

#### **Neni 5.**

Punëtorët që rishtazi kanë krijuar marrëdhënie pune, e të paaftësuar për punë të sigurt nuk mund të kryejnë punë në mënyrë të pavarur për aq kohë sa ata nuk janë aftësuar për punë të sigurt dhe nuk tregojnë sukses në kontrollimin e njohurive në testimin pas trajnimit për aftësim.

Kohëzgjatja e mungesës së aftësimin nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë nga momenti i caktimit në vendin e caktuar të punës ( lidhjes se kontratës se punës) dhe ngarkimi me detyrat konkrete të punës.

Punëtorët të cilët gjatë marrëdhënies së punës dërgohen (për arsye të ndryshme) në aftësim janë të detyruar t'i nënshtrohen verifikimit të aftësimin për punë të sigurt dhe mund të vazhdojnë me detyrat e punës të ngarkuara vetëm në qoftë se tregojnë sukses të kënaqshëm në testimin e bërë pas trajnimit aftësues, në të kundërtën ata detyrohen t'i rikthehen procesit të aftësimin edhe një herë, e më pas, nëse edhe pas përsëritjes ( ne afate prej 30 dite ) nuk tregon sukses të kënaqshëm duhet t'i ndërrohet vendi i punës dhe të caktohet në një vend me më pak përgjegjësi.

#### **Neni 6.**

1. Aftësimi i punëtorëve bëhet përmes programit për aftësim i cili duhet të bazohet në aktin e Vlerësimit të rrezikut dhe duhet të përfshijë të gjitha rreziqet e mundshme,

të gjithë dëmtuesit e mundshëm si dhe të gjitha ngarkesat trupore të dala nga Vlerësimi i rrezikut si dhe mënyrën e mënjanimet të tyre.

2. Punëdhënësi, KEK, përmes inspektorëve të sigurisë në punë, bënë hartimin e programit për aftësimin e punëtorëve dhe realizimin e atij programi, ose përmes personelit të certifikuar për aftësim të të punësuarve për punë të sigurt.
3. Programi i aftësimin duhet të përmbajë listën e udhëzuesve të shkruar për punë të sigurt për të gjitha punët të cilat punëtori i kryen.
4. Programi i aftësimin të punëtorëve ndërtohet nga pjesa teorike e aftësimin që realizohet për të gjithë punëtorët mbi bazën e natyrës së punës që ata kryejnë dhe aftësimin praktik në vendin e punës.
5. Aftësimi praktik i punëtorëve nuk aplikohet tek vendet e punës me rreziqe të vogla tek të cilat është i mjaftueshëm aftësimi teorik.
6. Programi i aftësimin duhet të përmbajë udhëzimet e prodhuesit të pajisjeve dhe të materieve kimike të cilat i ve në përdorim gjatë procesit të punës.

#### **Neni 7.**

Stafi i sigurisë në punë në KEK duhet të trajnohen në nivelin e trajnerëve dhe të certifikohen.

#### **Neni 8.**

Në procesin e aftësimin mbahet procesverbal, në të cilën duhet të figurojnë këto të dhënë:

1. Emri, mbiemri, numri i punës dhe numri personal i punëtorit që është në aftësim,
2. Punët që punëtori i kryen si dhe vendin (lokacionin) ku kryhen punët përkatëse,
3. Emërtimi, selia dhe numri personal identifikues i punëdhënësit
4. Vendi dhe koha e realizimit të procesit të aftësimin të punëtorëve
5. Modeli i trajnimit.

#### **Neni 9.**

Pjesën praktike të aftësimin të të punësuarve e bënë i autorizuari i cili drejtpërdrejt udhëheq me punëtorët e aftësuar të atij vendi të punës dhe inspektori i sigurisë në punë ose personeli i certifikuar për aftësim të punëtorëve për punë të sigurt.

#### **Neni 10.**

Procesverbali i aftësimin të punëtorëve bëhet përmes formularit FAS 1 (formulari i aftësimin për siguri) i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

## **Neni 11.**

Punëdhënësi, departamenti respektiv, është i detyruar të ruaj procesverbalet ose formularët përkatës me të cilin vërtetohet të trajnuarit për aftësim të punëtorëve.

Punëdhënësi, departamenti respektiv, është i obliguar që tua prezantojë këto procesverbale apo formularë të trajnimit, sa herë që është e nevojshme, inspektoratit të punës, institucioneve shtetërore, hetuesisë e gjyqësorit .

## **Neni 12.**

Pjesa teorike e trajnimit për aftësim përfshinë:

1. Ana ligjore e fushës së Sigurisë në punë
  - Rëndësinë dhe qëllimin e trajnimit për aftësim të punëtorëve për punë të sigurt
  - Organizimi dhe funksionimi i sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri në KEK
  - Detyrimet ligjore të punëdhënësit dhe ato të të punësuarve
2. Aspektet psiko-fizike të fushës së sigurisë në punë
3. Rreziqet e pranishme në vendet e punës të të trajnuarve ( ambientin e punës)
4. Mjetet për punë të sigurt dhe Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM)
5. Higjiena në vendet e punës
6. Lëndimet në vendet e punës dhe dhënia e Ndihmës së Parë

## **Neni 13.**

Pjesa praktike e trajnimit për aftësim përfshinë:

1. Mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes të mjeteve të punës, mjeteve mbrojtëse si dhe të PPM.
2. Verifikimi i vendit të punës dhe hetimi i rreziqeve apo dëmtuesve në vendin e punës
3. Ofrimi i Ndihmës së Parë për të lënduarin në vendin e punës.
4. Përdorimin e pajisjeve për zjarfikje dhe shpëtim

## **Neni 14.**

Në vendet e punës punëtori në mënyrë praktike njoftohet me:

- procesin teknologjik
- Mjetet dhe stabilimentet në vendet e punës
- Rreziqet, dëmtuesit dhe masat mbrojtëse gjegjëse në vendet e punës

#### **Neni 15.**

Verifikimi i njohurive të fituara, sipas Nenit 14, bëhet përmes testimit teorik dhe praktik.

#### **Neni 16.**

Verifikimin e njohurive të fituara, sipas Nenit 14, bëhet nga komisioni tre anëtarësh i përbërë nga inspektori i punës, përfaqësuesi i menaxhmentit si dhe udhëheqësi i drejtpërdrejt i punëtorit të trajnuar.

#### **Neni 17.**

Verifikimin e njohurive të fituara, sipas Nenit 14, për punëtorët me vendet e punës ku sipas Vlerësimit të rrezikut shkalla e rrezikshmërisë është e përballueshme, bëhet vetëm me plotësimin e testit me shkrim.

#### **Neni 18.**

Punëtorët të cilën nuk tregojnë rezultat të kënaqshëm në procesin e verifikimit të aftësisë, nuk mund:

- Të fillojë të punojë në mënyrë të pavarur në vendin e punës me të cilin ka krijuar marrëdhënie pune, dhe
- Të vazhdojë aktivitete punuese në vendin e punës ku është i përcaktuar, për aq kohë sa ai nuk mbërrin aftësimin e nevojshëm dhe nuk arrin të verifikojë para komisionit aftësitë e arrira.

#### **Neni 19.**

Aftësimi i punëtorëve për punë të sigurt, përveç rasteve të theksuar në Nenin 2, të kësaj rregulloreje, mund të bëhet edhe në rastet e tjera dhe do të quhet ***Aftësim i jashtëzakonshëm për punë të sigurt***, dhe do të bëhet sipas një vendimi me shkrim nga Drejtori i Divizionit mbi bazën e rekomandimeve të menaxherëve për SI&EMR- te KEK-ut të departamenteve apo inspektorëve të sigurisë në punë të divizionit përkatës, si dhe me rekomandim të inspektorëve të punës të inspektoratit shtetëror.

#### **Neni 20.**

Me qëllim të pasqyrës sa më të plotë për aktivitetet e Sigurisë në punë, është e nevojshme mbajtje s e evidencës së saktë për të trajnuarit për punë të sigurt.

**Neni 21.**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut

Prishtinë

.....

Kryesuesi i Bordit te Drejtoreve/KEK

.....



КООРПАЦИ ЗАБРОТНИ И БЕЗБЕДНОСТ  
 КИЛЕВО ОБРЕТ СЪВЪЗАНСОН Ј.С.С.  
 ЕНЕРГЕТСКА АДРПОРАЦИЈА КОСОВА О.Б.

**CERTIFIKATË**  
**Për aftësimin e punëtorit për punë të sigurt**

Për punëtorin .....  
 (Emri e mbiemri, nr i punës)

Punët të cilat punëtori i kryen në vendin e punës	
Vendi dhe koha e kryerjes së aftësimit	
Emri e mbiemri dhe numri i punës të personave që janë përfshirë në aftësim	

Në bazë të ecurisë së trajnimit dhe verifikimit të aftësimit për punë të sigurt, inspektori i mbrojtjes në punë apo i autorizuari për aftësim Vlerëson:

**Punëtori është aftësuar nga ana teorike dhe praktike për punë të sigurt në detyrat e tij të punës**

Kryetari i komisioni për verifikim te dijes .....  
*Emri e mbiemri* *nënshkrimi*

Anëtari i komisionit .....  
*Emri e mbiemri* *nënshkrimi*

Anëtari i komisionit .....  
*Emri e mbiemri* *nënshkrimi*

Punëtori i aftësuar .....  
*Emri e mbiemri* *nënshkrimi*